



ROLI DHE ANGAZHIMI I RINISË NË PARANDALIMIN E DHUNËS

Të rinjtë si akterë të ndryshimit në parandalimin
e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore
në Kosovë

Qershor, 2019



Falënderime

Anëtarët e Koalicionit dëshirojnë të falënderojnë të intervistuarit nga institucionet dhe organizatat e ndryshme për gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë dhe të japin informacione dhe të dhëna të paçmueshme për këtë raport.

OJQ-ja udhëheqëse për publikimin e Raportit

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë (YIHR KS) është organizatë joqeveritare e cila ka qëllim të promovoj të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike si themel për shoqëri përgjegjëse dhe progresive. YIHR KS është e dedikuar ndaj procesit të përbaljes me të kaluarën dhe pajtimin, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, fuqizimin e sundimit të ligjit si në Kosovë ashtu edhe në rajon. YIHR KS është organizatë anëtare e Koalicionit për të drejta të barabarta për të gjithë (ERAC)

Rr. Adrian Krasniqi, Nr. 5.
10000 Prishtina, Kosovo
Tel.: 038 748 018
Web: www.yihr-ks.org

Koalicioni për të drejta të barabarta për të gjithë - ERAC

Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë (ERAC) bashkon shtatë (7) OJQ-të që punojnë në fushën e **sundimit të ligjit** dhe **të drejtave themelore** në bashkëpunim të ngushtë me **nëntëmbëdhjetë (19) OJQ të angazhuara kryesisht në nivel lokal**, me një fokus të veçantë në krijimin e një rrjeti të qëndrueshëm të OJQ-ve që janë aktive në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të grupeve të rrezikuara dhe/ose të marginalizuara. Fokus specifik i projektit janë grupet si në vijim: **të gjitha komunitetet jo-shumicë** në Kosovë, **gratë, rinia**, dhe **komuniteti LGBT**. Edhe pse punojnë në tema dhe çështje të ngjashme, këto OJQ janë shpesh të ndara në bazë të grupeve të veçanta të synuara me të cilat punojnë apo sipas rajoneve ku ato janë aktive. Me krijimin e një bashkëpunimi strukturor në mes të OJQ-ve të përzgjedhura dhe me ofrimin e mundësive formale për mësim të vazhdueshëm, veprimi prodhon shkëmbimin e njohurive dhe përvojës në mes të OJQ-ve, fuqizon kapacitetet e tyre për avokim tek institucionet përkatëse qendrore dhe komunale dhe rrit dukshmërinë e tyre në terren.

Anëtarë të ERAC-ut janë organizatat si më poshtë:

- Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë –Organizatë lider e Koalicionit;
- Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore– anëtare e Koalicionit;
- Qendra për Barazi dhe Liri të komunitetit LGBT në Kosovë (CEL) – anëtare e Koalicionit;
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore - anëtare e Koalicionit;
- Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - anëtare e Koalicionit;
- Kosovo 2.0 – anëtare e Koalicionit;
- Qendrën për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD) - anëtare e Koalicionit;

Vërejtje

Ky botim është realizuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Koalicioni për të drejta të barabarta për të gjithë është përgjegjëse rreth përmbajtjes së këtij publikimi, andaj ajo në asnjë mënyrë nuk mund të paraqitet si qëndrime të Bashkimit Evropian.

Ky raport është publikuar në kuadër të projektit katër (4) vjeçar: “Koalicioni për të drejta të barabarta për të gjithë” i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë

E drejta e autorit[©]

Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë (ERAC), maj 2019. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem të rikthimit ose të transmetohet në asnjë formë ose me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik, foto-kopjimi, regjistrimi ose ndryshe, pa lejen paraprake të ERAC-ut.



ROLI DHE ANGAZHIMI I RINISË NË PARANDALIMIN E DHUNËS

Të rinjtë si akterë të ndryshimit në parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore në Kosovë

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	7
HYRJE.....	10
METODOLOGJIA.....	12
KONTEKSTI.....	14
Dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore në Kosovë.....	14
Definicionet ligjore.....	15
Kush mund të zhvillojë dhe implementojë strategjitë parandaluese.....	17
Strategjitë ekzistuese dhe të kaluarat.....	18
Çfarë është duke munguar.....	19
Rëndësia e inkuadrimin të rinjve.....	20
DHUNA E PARË NGA PERSPEKTIVA E TË RINJVE.....	22
Temat e përbashkëta të dala fokus grupet.....	22
PËRFUNDIMET.....	25
REKOMANDIMET.....	26

LISTA E AKRONIMEVE

CEDAW	Konventa për eliminimin e diskriminimit ndaj grave
OSHQ	Organizatat e shoqërisë civile
DHF	Dhuna në familje
DHBGJ	Dhuna në bazë gjinore
KVRL	Këshilli i Veprimit Rinor Lokal
MKRS	Ministria e kulturës, rinisë dhe sportit
MASHT	Ministria e kulturës, rinisë dhe sportit
MD	Ministria e drejtësisë
MPB	Ministria e punëve të brendshme
OSBE	Organizatapër siguri dhe bashkëpunim në Evropë
ZKM	Zyra e kryeministrit
ZHPR	Zhvillimi Pozitiv Rinor
GSG	Grupi për siguri dhe gjini
UNICEF	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kjo analizë e realizuar në kuadër të projektit “Equal Rights for All Coalition”, shqyrton politikat parandaluese të dhunës në familje dhe dhunës në bazë gjinore në Kosovë, si dhe matë shkallën e inkuadrimin të të rinjve në këto politika. Në bazë të raportit të vlerësimit mbi Programin e Kosovës Kundër Dhunës në Familje¹, dhuna në familje është një nga format më të përhapura të dhunës ku në shumicën e rasteve fëmijët dhe gratë janë viktimat të kësaj dhune. Dallimi ndërmjet këtyre formave të dhunës nuk është edhe aq i prerë duke konsideruar faktin që shumica e dhunës në baza gjinore manifestohet si dhunë në familje.

Këtu do të analizojmë se si ligji i Kosovës e definon dhunën, cilat janë strategjitë dhe politikat ekzistuese që kanë për qëllim parandalimin e këtyre formave të dhunës në shoqërinë tonë, cilat institucione janë përgjegjëse për mbrojtjen e viktimave të dhunës, si dhe cilat janë ato institucione që zhvillojnë politika të cilat mund ti angazhojnë të gjithë në programet për parandalim të dhunës. Ne analizojmë se sa janë të rinjtë e angazhuar në programet për parandalim të dhunës si dhe cilat janë besimet dhe dija e tyre rreth dhunës në Kosovë.

Hulumtimi është realizuar në dy faza. Në fazën e parë, është realizuar një hulumtim tavoline. Gjatë kësaj kohe janë mbledhur të dhëna dytësore nga burimet ekzistuese të cilat janë tëqasshme. Të dhënat primare janë marrë gjatë fazës së dytë të hulumtimit ku janë realizuar fokus grupe dhe intervistat gjysme të strukturuar. Për ti shpalosur trendet në opinionet e të rinjve (nga moshë 15 – 24, ashtu siç definohet në Ligjin për fuqizimin dhe pjesëmarrje të rinisë Nr. 03/L-45), shtatë grupe të fokusit janë realizuar. Në mënyrë që ti pasqyrojmë karakteristikat e rinisë anëmbanë Kosovës, mostrat përfaqësuese janë nxjerrë nga shtatë rajonet e Kosovës: Ferizaj, Gjiilan, Gjakovë, Mitrovicë, Pejës, Prishtinë dhe Prizren. Po ashtu janë realizuar intervistat gjysmë të strukturuar me zyrtarë të sektorit rinor në nivel lokal në mënyrë që ti hulumtojmë se si janë strukturuar politikat lokale për nevojat e të rinjve në Kosovë.

Shtuar kësaj, janë identifikuar edhe kanalet të cilat qeverisja në nivel lokal dhe kombëtar i shfrytëzojnë për angazhimin e të rinjve në parandalim të dhunës si dhe mënyrat se si ata mund ti përpilojnë planet e veprimit dhe strategjitë lokale në mënyrë që ta arrijnë këtë cak. Ne arritëm të bëjmë krahasimin ndërmjet asaj se çfarëzyrtaret e sektorit të rinisë konsiderojnë si sfida kryesore për rininë në rajonet e tyre me atë se çfarë vetë të rinjtë mendojnë se janë ato sfida. Kishte mospërputhshmëri rreth

¹ Ariana Qosaj Mustafa, “Report on Evaluation of Kosovo Program against Domestic Violence” (Pristina, RKS: Office of the National Coordinator Against Domestic Violence, 2015) linku: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/5CB82F64-2F08-426B-AC62-E71E7A56D30A.pdf>

kësaj çështje pasi që nëzyrtaret kanë tendencë mos ta shohin DHF dhe DHBGJ si problem, ndërkohë që vetë të rinjtë kanë theksuar se këto forma të dhunës janë problem më të cilën ata përballen dhe që i parandalon ata të arrijnë potencialin e plotë dhe të jetojnë një jetë të sigurt dhe të lumtur në këtë shoqëri.

Gjetjet e këtij hulumtimi shërbejnë për informimin e institucioneve përkatëse për një strategji e cila do të fokusohet në rolin e rinisë në parandalimin e dhunës, si dhe i përkujton ata rreth planifikimit dhe implementimit të strategjive që kanë për bazë nevojat e njerëzve, sidomos ato të grupeve më të cenueshme. Këto gjetje tregojmë se strategjitë ekzistuese sikurse Strategjia për Rini 2013 – 2017 (edhe pse tani më nuk është vlefshme pasi që MKRS-ja është duke e përpiluar strategjinë e re), Plani strategjik i arsimit në Kosovë dhe plani i veprimit 2017 – 2021, Strategjia Nacionale e Kosovës për mbrojtje ta dhunës familjare 2016 – 2020, etj. edhe pse i mbulojnë disa çështje kyçe të përfshirjes e të rinjve në jetën publike, qoftë në vendimmarrje apo nëpërmjet aktivizmit të OJQ-ve, këto nuk i shohin problemet e dhunës familjare dhe gjinore si çështje të cilat i përkasin rinisë, edhe pse këto të fundit janë një ndër faktorët më të rëndësishëm që rrezikojnë sigurinë dhe mirëqenien e tyre. Fjala “dhunë” as që përmendet në Strategjinë për Rini 2013 – 2017. Edhe pse disa objektivë të Strategjisë Kombëtare të Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 2016 – 2020 përfshijnë rritjen e vetëdijes si dhe parandalimin e dhunës, rinia nuk merret si grup specifik që mund të luaj rrol të madh në parandalimin e DHF dhe DHBGJ nëpërmjet metodave primare të parandalimit. Në përgjithësi, strategjitë ekzistuese nuk i shfrytëzojnë kanalet e duhura për ta adresuar problemin e DHF dhe DHBGJ, nuk përqendrohen tek rinia si subjekte më vete me fuqi që tëndryshojnë realitetin, si dhe nuk fokusohen në fuqizimin e rrolit të tyre për të krijuar një shoqëri më të mirë për të gjithë.

Nga diskutimi që kemi realizuar me të rinjtë ne kemi vërtetuar faktin se të rinjtë ballafaqohen me të njëjtat sfida të DHF dhe DHBGJ, pa marrë parasysh rajonin nga i cili vijnë. Shtuar kësaj, edhe pse shumica e tyre mund të identifikojnë dhunën fizike dhe psikologjike, ata me më shumë vështirësi mund të dallojnë format tjera të dhunës sikurse ngacmimi seksual, dhuna ekonomike, nuk mund të identifikojnë mekanizmat tjerë pos policisë ku mund ta raportojnë dhunën, si dhe nuk kanë informata mbi ndërhyrjen kur janë dëshmitarë. Dhuna ka tendencë të jetë gjë e normalizuar në rrethin e tyre, qoftë në shkollë, universitete apo në familjet e tyre.

Bazuar në gjetjet tona, ne rekomandojmë që MKRS-ja, krahas Strategjisë për Rini, të zhvillojë një strategji shtesë e cila fokusohet në inkuadrimin e rinisë në parandalimin e të gjitha formave të dhunës që rrjedhin nga normat toksike gjinore sikurse dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore. Ky parandalim duhet të arrihet nëpërmjet sfidimit dhe ndryshimit të këtyre normave. Disa nga hapa që duhen tëndërmirënj janë: të përfshihen programet për parandalimin e dhunës në Strategjinë e re për rini

2019 – 2023, të zhvillohen programe të parandalimit primar ku do të përfshihej rinia si dhe të përqendrohen në parandalimin e DHF dhe DHBGJ. Rekomandime për sektorët e rinisë në kuadër të Drejtorive për Kulturë, Rini dhe Sport përshijnë: zhvillimin dhe implementimin e strategjive lokale për rritje të vetëdijes rreth formave të ndryshme të dhunës, të monitorojnë dhe vlerësojnë implementimin e kësaj strategjie, avokojnë për programe të cilat fokusohen në ndryshime normaveshoqërore gjinore që normalizojnë dhunën. Nëse dëshirojmë të krijojmë ndryshim dhe zhvillojmë politika të cilat janë relevante për kohën dhe vendin është më se e rëndësishme që të ekzistojnë komponentë specifik që përqendrohen në probleme specifike sikurse DHF dhe DHBGJ.

Dhuna, si shkelje dhe si rreziku më i lartë për të drejtat e njeriut, është një nga sfidat kryesore për krijimin e një shoqërie të barabartë dhe të drejtë për të gjithë. Askush nuk është i/e sigurtë dhe i/e lirë të arrijnë potencialin e tyre të plotë në një shoqëri të dhunshme. Nëmënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë, grupet e ndryshme janë të ndikuara nga dhuna në të gjitha format e saja, ndër ato grupe janë edhe të rinjtë të cilët janë në rrezik të jenë viktimë, të jenë dëshmitarë dhe të kryejnë vepra të dhunshme, sidomos ata që jetojnë në familje abuzive. Dhuna, në shumicën e rasteve, është gjë e normalizuar në diskursin publik në Kosovë. Mediat tradicionale, si dhe rrjetet sociale, i kontribuojnë këtij problemi, gjë që është mjaft shqetësuese duke marrë parasysh ndikimin që këto media tek të rinjtë. Prandaj është shumë e rëndësishme të krijohen mjete ku të rinjtë do të mund të diskutojnë mbi dhunën si dhe çështjet tjera që i preokupojnë rreth mirëqenies fizike dhe shoqërore. Për ta arritur këtë, ne duhet të shfrytëzojmë çdo mekanizëm ekzistues, apo edhe të themelojmë mekanizma të ri në raste që kjo është e nevojshme, në mënyrë që të arrijmë tek të rinjtë dhe ti inkuadrojmë ata në diskutim të shëndoshë rreth këtyre çështjeve. Është vështirë për të rinjtë që të tentojnë për një jetë më të mirë kur përballen me kushtet e tilla, prandaj është thelbësore që t’ju krijohen mundësitë për të vepruar si subjekt të ndryshimit në vend se të shihen si objekt pasiv që konsumojnë këta narrativë të dëmshëm.

Rezoluta 2550 e Këshillit të Sigurimit mbi “Rininë, Paqen dhe Sigurinë”, edhe pse fokusohet në shtetet në konflikt dhe post-konfliktuale si dhe në ekstremizmin e dhunshëm, është shembull i mirë që tregon rëndësinë e inkuadrimin e të rinjve në trajtimin e sfidave dhe çështjeve të ndryshme të shteteve. Pasi që DHBGJ dhe DHF janë një ndër problemet madhore të sigurisë njerëzore, sidomos për gratë dhe rininë, rezoluta është shembull i një praktikë e mirë të inkuadrimin të rinisë në programe të parandalimit të dhunës të cilën mund ta marrim si dhe t’ju japim hapësirën e njëjtte në proces të rinjve sikurse që e kanë në rezolutë. Kjo rezolutë, pra, do të funksionoj si një alarm për ne mbi rëndësinë e të rinjve si subjekt të ndryshimit kur janë në pyetje çështjet e ndryshme të sigurisë, e që natyrisht përmbajnë edhe format e ndryshme të dhunës sikurse dhuna në familje dhe dhunën në baza gjinore. Ndër pesë shtyllat e identifikuar në këtë rezolutë janë edhe ato të pjesëmarrjes dhe parandalimit. Kjo vetëm sa tregon rëndësinë e inkuadrimin aktiv të rinisë në programe kundër dhunës, në mënyrë që këto programe të jenë sa më efikase si dhe rëndësinë që të punohet në programe parandaluese. Sado me rëndësi që është e që të punohet në të gjitha nivele në parandalimin e dhunës, parandalimi primar ka potencial që të jetë një nga strategjitë më efektive të parandalimit, pikërisht se fokusohet në rrënjën e problemit dhe parandalon dhunën para se të ndodhë ajo. Prandaj, një qasje efektive për parandalimin e dhunës do të ishte edhe puna me të rinjtë në programin

e parandalimit primar. Për këtë, neve na nevojiten strategji efektive që të krijohen mekanizma për t'ju dhënë zë më të madh tërinjve si dhe t'ju mundësojnë atyre të jenë pjesë e dizajnit, implementimit, monitorimit dhe vlerësimit të programeve në të gjitha nivele, si lokale, nacionale, rajonale dhe ndërkombëtare. Kjo rezolutë është veçse një vërtetim i një përkushtimi global për inkuadrimin e popullatës së re në parandalimin e dhunës.

Kosova si shtet me popullsi të re, ku 53 përqind e popullatës është nën moshën 25 vjeçare, duhet t'ju bashkëngjitet përpjekjeve globale për ta inkuadruar rininë në programe që promovojmë paqe të qëndrueshme dhe parandalim të dhunës. Nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme përderisa ekziston rreziku i dhunës familjare dhe dhunës në baza gjinore në shoqërinë tonë dhe ku tërinjtë rriten në rrethana ku dhuna pranohet dhe promovohet. Duke ju qasur tërinjve si subjekt të ndryshimit ne mund t'ju krijojmë atyre mundësi të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të arrijnë potencialin e tyre të plotë në shoqëri të lirë nga dhuna.

Inkuadrimi i tërinjve në parandalim të dhunës duhet të bëhet në një gamë të gjerë. Prandaj të gjitha institucionet përgjegjëse dhe që punojnë me të rinjtë duhet të jenë të inkuadruara në këtë proces. Nëse është e nevojshme, mekanizmat e ri duhen të themelohen. Problemi i dhunës duhet të adresohet në nivele të ndryshme, prandaj një bashkëpunim më i gjerë i institucioneve ekzistuese është i nevojshëm në adresimin e parandalimit të dhunës, sidomos për të koordinuar punën me grupet e tërinjve. Këto institucione duhet të jenë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MRS), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Drejtoritë Komonale për Kulturë dhe Arsim, shkollat e mesme, universitetet, Koordinatorin Nacional Kundër Dhunës në Familje, Agjensionin për Barazi Gjinore, ndër të tjerash. Një palë tjetër e interesit janë edhe Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHQ), të cilat mund të luajnë rol kyç në zbatimin e këtij procesi, ta ofrojnë ekspertizën e tyre për t'ju qasur të rinjve, si dhe të ofrojnë ndihmën e tyre në zhvillimin e programeve të reja dhe përfshirës.

Prandaj Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë (YIHR KS), si një organizatë që punon me të rinjtë në fushën e të drejtave të njeriut, ka realizuar këtë hulumtim për ta vlerësuar punën që momentalisht implementohet rreth pjesëmarrjes e të rinjve në programe për parandalim të dhunës. Të gjeturat nga ky hulumtim mund të informojnë institucione përkatëse rreth nevojës për një strategji e cila përqendrohet në rolin e rinisë në programe të parandalimit të dhunës, si dhe i informon ata për përgjegjësitë të planifikojnë dhe implementojnë strategjitë që mund të përmirësojnë jetën e të gjithëve, sidomos të grupeve më të cënueshme sikurse gratë, të rinjtë dhe minoritetet etnike.

Metodat e përziera janë përdorur për këtë hulumtim, pra metodat kualitative dhe kuantitative, në mënyrë që më mirë të kuptohet dhe hulumtohet problemiduke ju qasur nga perspektivat e ndryshme. Të dhënat janë mbledhur nga burimet primare dhe dytësore.

Procesi i hulumtimit është realizuar në dy faza. Gjatë fazës së parë është realizuar njëhulumtim në tavolinë. Kjo fazë na ka mundësuar që të mbledhim dhe analizojmë të dhënat dytësore nga burimet ekzistuese. Këto të dhëna janë mbledhur nga dokumentet e publikuara qeveritare si dhe nga hulumtimet e publikuara nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare. Këto dokumente janë analizuar që të kuptojmë se si është adresuar roli dhe angazhimi i të rinjve në parandalimin e dhunës, si dhe çfarë tjetër mund të bëhet për ti përmirësuar ato. Konventat Ndërkombëtare e Të Drejtave të Njeriut si dhe Rezoluta e OKB 'së mbi Rininë, Paqen dhe Sigurinë janë shqyrtuar, si dhe publikimet akademike në fushën e DHF dhe DHBGJ. Strategjitë dhe ligjet ekzistuese mbi DHBGJ dhe DHF janë krahasuar me ato të rajonit sikurse ato të Shqipërisë për ta parëqasjen e tyre rrethinkuadrimin e të rinjve në parandalimin e dhunës. Strategjia e Kosovës për Rininë 2013 – 2017, Strategjia Kombëtare e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe plani i veprimit 2016 – 2020, Ligji mbi Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinisë në Kosovë, si dhe Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, pasi që janë dokumente kryesore të cilat koordinojnë punën qëmerret me dhunën në të gjitha nivelet, ishin pikënisja e hulumtimit mbi mënyrën e veprimit të Kosovës karshi parandalimit të dhunës në përgjithësi dhe posaçërisht mbi shqyrtimin e nivelit të agjencisë e të rinjve në këto procese.

Të dhënat primare janë mbledhë gjatë fazës së dytë të hulumtimit gjatë të cilit janë realizuar grupe të fokusit si dhe intervista gjysmë të strukturuar. Për ti shpalosur trendet e opinionit të të rinjve (15 – 24 vjeç siç e definon ligji), shtatë fokus grupe janë realizuar. Në mënyrë që ti pasqyrojmë karakteristikat e rinisë anëmbanë Kosovës, mostrat përfaqësuese janë nxjerrë nga shtatë rajonet e Kosovës: Ferizaj, Gjiilan, Gjakovë, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Grupet e fokusit janë realizuar në secilin rajon me nga gjashtë deri në dhjetë pjesëmarrës. Në çdo grup të fokusit, pjesëmarrësit ishin të moshave tëndryshme nga 15 – 24 vjeç dhe në shumicën e rasteve kishte përfaqësim tëbarabartë të gjinisë dhe pjesëmarrësve nga vendbanimet rurale dhe urbane.

Shtuar kësaj, për ti shqyrtuar politikat në nivel lokal dhe të shohim se si janë të përshtatura nevojave të popullatës së re, të dhënat primare janë mbledhur edhe nëpërmjet intervistave gjysmë të strukturuar me zyrtarët e Drejtorive të Kulturës, Rinisë dhe Sportit nga shtatë komunat e Kosovës: Ferizaj, Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë,

Pejë, Prishtinë dhe Prizren; pra të njëjtat komuna sikurse ato që janë përzgjedhë si mostër përfaqësuese për grupet e fokusit. Ata janë pyetur rreth planit të tyre të punës si dhe sa shumë konsultohen me të rinjtë rreth saj. Shtuar kësaj, ata janë pyetur edhe për sasinë e punës qëpërqendrohet në mirëqenën shoqërore dhe emocionale e të rinjve si dhe nëse ata kanë pasur ndonjë aktivitet që merret me parandalimin e dhunës dhe në rast se po, cili ishte roli i të rinjve në këtë proces.

Dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore në Kosovë

Të dhënat tregojnë që ne jetojmë në një botë të dhunshme dhe, për disa njerëz, dhuna duket se është i vetmi medium që ata e njohin për zgjedhjen e ndonjë problemi. Nganjëherë dhuna shihet si e vetmja mënyrë që ata të mirëmbajnë apo përparojnë statusin e tyre social, nganjëherë si mjet për ta forcojnë kontrollin ndaj të tjerëve. Pra ka në shumë mënyra që individët e përdorin dhunën. Organizata Botërore e Shëndetësisë tregon që në nivel global, një në tre gra përjetojnë dhunë gjatë jetës së tyre, dhe shumica nga to janë viktimat të dhunës në familje.² Normat shoqërore, sidomos ato që kanë të bëjnë me gjininë, nxisin përdorimin e dhunës nga një grup shoqëror ndaj të tjetrit. Prandaj ne duhet të punojmë në ndryshimin e këtyre normave nëse dëshirojmë ta krijojmë një shoqëri më të mirë për të gjithë. Mirëpo, ne këtë nuk mund ta bëjmë pa i inkluadruar të rinjtë si grup më i cënueshëm dhe më premtues. Normat e dëmshme shoqërore barten tek të rinjtë dhe ata rriten me potencial që të jenë autor i dhunës apo viktimë e radhës, pikërisht për shkak se dhuna është gjuha e cila ju është mësuar. Hulumtimet tregojnë që të rinjtë e Kosovës (18 – 24 vjeç) kanë më shumë prirje që të jenë viktimat të dhunës në familje më shumë se cili do grup tjetër shoqëror.³ Ne duhet ta ndalim këtë rreth vicioz dhe të ndihmojmë në krijim e një gjeneratë të re e cila do të dëshirojë të jetojë në një botë ku familja është dhe qëndron hapësirë e sigurve, po ashtu edhe rrugët dhe cili do vend tjetër. Në Kosovë është thelbësore që të punohet me rininë pasi që ata përbëjnë 53% të popullatës.

Sipas Raportit Vlerësues të Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje, dhuna në familje është një ndër format më të përhapura të dhunës në shoqërinë Kosovare. Në shumicën e rasteve, gratë dhe fëmijët janë viktimat të kësaj dhune. Sipas këtij raporti, institucionet përgjegjëse në Kosovë dalin në ndihmë mesatarisht 1,000 viktimat në vit, 80% nga të cilat janë gra, pësuar nga fëmijët dhe burrat e moshuar.⁴ Shumica e Kosovarëve kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës në familje. Të gjeturat nga Analiza Gjinore e Kosovës (2018) tregojnë që dhuna në familje është mjaft e përhapur; 62% e popullatës në Kosovë kanë përjetuar DHF gjatë jetës së tyre, ndërkohë që 68% e tyre ishin gra. Vetëm gjatë vitit 2017, ishin 1125 raste të DHF të raportuara pranë Policisë së Kosovës ku 76% e rasteve ishin gra. Duke marrë parasysh faktin që niveli

² World Health Organization. "Violence Against women." Së fundmi e modifikuar me 19 Nëntor, 2017. <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/violence-against-women>.

³ Nicole Farnsworth, etj. No More Excuses (Pristina, RKS: Kosovo Women's Network, 2015) Linku: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20151124105025622.pdf>

⁴ Ariana Qosaj Mustafa, "Report on Evaluation of Kosovo Program against Domestic Violence" (Pristina, RKS: Office of the National Coordinator Against Domestic Violence, 2015) linku. <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/5CB82F64-2F08-426B-AC62-E71E7A56D30A.pdf>

i raportimit në Kosovë ka tendence që të jetë më i ulët, numri i grave dhe burrave që përjetojnë dhunë mund të jetë më i lartë sesa ai që raportohet.⁵ Dhuna në familje ende shihet si çështje private dhe individët kanë tendence ta shohin si gjë normale dhe çështje e brendshme familjare. Sipas raportit të UNICEF-it mbi Kosovën, lufta e 1999'tës në Kosovë ka formësuar diskursin publik ndaj dhunës ndëretnike, mirëpo duke lënë anash dhunën në familje dhe dhunën në baza gjinore para, gjatë dhe pas lutës.⁶ Pra, dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore ende mbeten rrezik i madh për sigurinë dhe lumturinë në Kosovë, ndërkohë që të rinjtë janë të cenueshëm ti përjetojnë, të jenë dëshmitar apo të jenë autorë të dhunës.

Sa i përket të dhënave të hulumtimit të kryer nga OSBE-ja në Kosovë, shihet që çdo i dyti në dhjetë burra kanë qenë dëshmitarë të dhunës fizike ndaj nënave të tyre nga ana e babait të dëshmitarit apo nga ana e partnerit të nënës, së pakunjë herë gjatë jetës së tyre. Shtuar kësaj, 40% e burrave kanë theksuar se ishin viktimat të bulizmit apo formave të ndryshme të ngacmimeve në lagjet janë rritur apo shkolla ku kanë shkuar. Burrat të cilët kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës dhe/apo të ngacmimit, si dhe ata që ishin dëshmitarë të dhunës ishin më tëpirur që të kenë aversion ndaj idesë së barazisë gjinore. 12 % e tyre kanë deklaruar që se paku një herë në jetë kanë përdorur shuplakë, kanë grushtuar partneren e tyre apo e kanë gjuajtur ndonjë objekt. Shtuar kësaj, një në 20 burra kanë theksuar se kanë kryer marrëdhënie seksuale me një grua pa lejen e saj, kurse një në 25 burra kanë deklaruar se e kanë detyruar partneren e tyre (gruan apo të dashurën) që të kryejnë marrëdhënie seksuale me ta.⁷ Sipas të dhënave nga ky hulumtim, burrat në përgjithësi kanë më shumë tendencë të pajtohen me normat e kulturës përdhunuese sesa gratë. Këto të dhëna duhet të jenë alarm për të ne që të kuptojmë rëndësinë e të punuarit në programet e parandalimit primar në fushën e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore, si dhe sa e rëndësishme është që të rinjtë, gratë dhe të gjitha gjinitë, të angazhohen si subjekte të ndryshimit në këtë mjedis toksik që promovon dhe përkrah dhunën.

Definicionet ligjore

Kosova ka miratuar Ligjin për Barazi Gjinore për herë të parë në vitin 2004 dhe që nga ajo kohë është bërë njëpërparim i konsiderueshëm në legjislacionin që ka të bëjë me barazinë gjinore dhe luftën kundër DHF dhe DHBGJ. Në vitin 2015 Parlamenti i Kosovës e miraton legjislacionin për barazi gjinore dhe kundër-diskriminimit.

⁵ Nicole Farnsworth, et al. Kosovo Gender Analysis (Pristina, RKS: Kosovo Women's Network, 2018), 15. Linku: <https://womensnetëork.org/wp-content/uploads/2018/10/womens-network.pdf>

⁶ UNICEF- Kosovo, Policy Options on Domestic Violence / Gender Based Violence in Kosovo (Pristine, RKS: UNICEF, 2013), 11. Linku: https://www.unicef.org/kosovoprogramme/Final_Policy_Options_Albanian_web.pdf

⁷ OSCE/UNFPA, Men's Perspective on Gender Equality in Kosovo (Pristina, RKS: OSCE/UNFPA, 2018) linku: <https://www.osce.org/sq/mission-in-kosovo/382510?download=true>

Mirëpo, edhe pse korniza ligjore e Kosovës në fushën e barazisë gjinore është në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, të drejtat e grave vazhdojnë të jenë të rrezikuara, edhe nëkuadër të kornizës së tanishme ligjore. Bazuar në këtë, Grupi për Siguri dhe Barazi Gjinore (GSBG), si një grup i përbërë organizatat vendore dhe ndërkombëtare dhe OSHC kanë kërkuar implementim efektiv të këtij legjislacioni. Ndër tjerash, GSBG ka kërkuar “strategji efektive të parandalimit”⁸, të cilat nuk mund të jenë plotësisht efektive nëse të rinjtë nuk janë të inkuadruar në të. Prandaj, strategjitë e parandalimit kërkojnë njëpërqendrim më të madh tek popullsia e re.

Që të jemi nëgjendje të planifikojmë dhe zhvillojmë strategji efektive për të luftuar DHBGJ dhe DHF, është më se e nevojshme që të definohen në ligj të gjitha format e dhunës. Organizatat e Shoqërisë Civile kanë ngritur shqetësime rreth mungesës së definicionit të dhunës në familje në kodin kriminal. Definicioni ligjor i dhunës në familje është inkuadruar në këtë kod tek në Janar të këtij viti (2019). Kodi kriminal i Kosovës nënenin 248 e definon dhunën në familje si “Kushdo që e kryen dhunë ose keqtrajtimi fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare”⁹. Ligji për Mbrojtjen Kundër Dhunës në Familje e definon dhunën si “një apo më shumë veprime tëqëllimshme, apo ndalesa kur kryhen nga një person ndaj personit tjetër me të cilën ai ose ajo janë nëmarrëdhëniejefamiljare”¹⁰. Mirëpo ky ligj nuk përmendparandalimin primar, përderisa ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë nuk e përmend fjalën “dhunë” as tëvetmen herë. Mirëpo të rinjtë mund të marrin pjesë në politika sektoriale në fushat të cilat janë të përmendura në nenin 13.¹¹ Ky ligj po ashtu mundëson qeverisjes lokale të zhvillojë politika rinore lokale në konsultim me Këshillat e Veprimt Rinor Lokal (KVRL) në bazë të nevojave specifike. Komuna e Gjakovës tanimëështë duke e zbatuar këtë, pasi që Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e kësaj komune ka zhvilluar një plan veprimi përkrah Strategjisë dhe Planit të Veprimt të Rinisë.

Një definicion për dhunën në baza gjinore është dhënë në Ligjin nr. 05/L-020=1.18 MBI BARAZINË GJINORE: “(dhuna në baza gjinore) Nënkupton të gjitha aktet e dhunës që rezultojnë apo kanë të ngjarë të rezultojnë në dëmtim apo vuajtje fizike, seksuale, psikologjike, sociale apo ekonomike në baza gjinore, duke përfshirë kërcënime për akte të tilla, shtrëngim, apo heqje arbitrare të lirisë, qoftë kur kjo

⁸ UNMIK “Security and Gender Group Calls for a Strengthened Institutional Response to Prevent and Respond to Gender-based Violence” (Pristina, RKS, 24 August, 2018) linku. <https://unmik.unmissions.org/security-and-gender-group-calls-strengthened-institutional-response-prevent-and-respond-gender-base>

⁹ Assembly of Republic of Kosovo, Code No. 04/L-082, “Criminal Code of the Republic of Kosovo”. Article 248. Linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

¹⁰ Assembly of Republic of Kosovo, Law No. 05/L-20= 1.18. On Gender Equality. linku. <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf>

¹¹ Ministry of Culture, Youth and Sport, “Kosovo Strategy for Youth 2013-2017” linku. https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/KOSOVO_STRATEGY_FOR_YOUTH.pdf

ndodh në jetën publike apo private”¹². Ekzistojnë dy definicione në dy konventa kyçe ndërkombëtare mbi barazinë gjinore dhe luftimin e DHBGJ, e para në Konventën për Eliminimin e Të Gjitha Llojeve të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)¹³ si dhe Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Konventa e Stambollit për dhunën në Familje¹⁴ CEDAW dhe Konventa e Stambollit e definojnë dhunën gjinore si dhunë cila drejtohet kundër grave për faktin që ato janë gra apo që i ndikon grave në mënyrë jo-proporcionale”.¹⁵¹⁶

Kush mund të zhvillojë dhe implementojë strategjitë parandaluese

Institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare që punojnë me rini në Kosovë mund të zhvillojnë, implementojnë dhe avokojnë për strategjitë për parandalimin e dhunës, me fokus në inkuadrimin e të rinjve. MKRS-ja, MASHT-i, Drejtoritë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe drejtoritë e Arsimit në të gjitha komunat e Kosovës, Shkollat e Mesme dhe Universitetet, Koordinatorin Nacional për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Agjensioni për Barazi Gjinore, Organizatat që punojnë me rini, të drejtat e njeriut dhe parandalim të dhunës, të gjitha këto mund të kontribuojnë dhe të shtyjnë përpara politika të cilat përqendrohen në angazhimin e të rinjve në parandalimin e DHF dhe DHBGJ

Secili nga këto palë të interesit kanë potencial që t’ju qasen një grupi të madh të të rinjve. Ministritë mund të zhvillojnë strategji kombëtare të cilat do të zbatoheshin në nivel lokal, ndërsa pushteti lokal si dhe organizatat e tjera lokale do të mund t’zbatonin këto strategji si dhe të zhvillojnë strategji lokale në bazë të nevojave të tyre specifike. Fondet të cilat vijnë nga organizatat ndërkombëtare mund të përdoren për ti adresuar çështjet e parandalimit të DHF dhe DHBGJ si një ndër sfidat kryesore të mirëqenies e të rinjve në shoqërinë tonë.

¹² Assembly of Republic of Kosovo, Law No. 03/L – 182, “On Protection Against Domestic Violence”. linku. <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20a.pdf>

¹³ UN Women, The Convention on the Elimination of All Forms of Discrimination against Women. Linku: <https://www.un.org/en/women/attach/daw/cedaw/text/econvention.htm>

¹⁴ Council of Europe, Convention on Preventing and Combating Violence Against Women and Domestic Violence. linku. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168046031c>

¹⁵ United Nations Human Rights Council, Committee on the Elimination of Discrimination Against Women, “General Recommendations”, linku. <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CEDAW/Pages/Recommendations.aspx>

¹⁶ Council of Europe, Convention on Preventing and Combating Violence Against Women and Domestic Violence. linku. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168046031c>

Strategjitë ekzistuese dhe të kaluarat

Ekziston një listë e 57 dokumenteve strategjike që janë valide në Kosovë momentalisht.¹⁷ Disa nga këto strategji qëpërqendrohen tek rinia dhe arsimimi janë dokumente kyçe me të cilat mund të përmirësohen kapacitetet dhe kështu të rritet përfshirja e rinisë në jetën publike. Këto strategji duhet të reflektojmë mbi nevojat dhe mundësitë e të rinjve në Kosovë dhe të jenë qëllim kryesor i Ministrive përkatëse. Mirëpo, DHF dhe DHBGJ nuk janë një nga problemet të cilat theksohen në këto strategji, edhe pse ato me të vërtetë janë një ndër sfidat kyçe për rininë në Kosovë. Strategjitë tjera që fokusohen në parandalimin e dhunës nuk e përfshijnë rininë si grup i synuar në strategjitë e tyre. Kjo është për faktin se ato fokusohen më shumë në parandalimin sekondar dhe terciar dhe jo aq shumë në atë primar. Disa nga strategjitë kryesore të cilat merren me rininë, arsimimin, shëndetësinë dhe parandalimin e dhunës janë: Strategjia e Kosovës për Rininë 2013 – 2017 – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)¹⁸; Strategjia për Promovimin e Shëndetit në Shkollë në Kosovë 2009–2018¹⁹, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë si dhe Plani i Veprimit 2017–2021²⁰ – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016–2020²¹ – Ministria e Drejtësisë (MD), Strategjia Kombëtare e Kosovës kundër Terrorizmit 2012–2017²², Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2015–2019²³ – Ministria e Punëve të Brendshme (MBP); Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015 – 2020²⁴ – Zyra e Kryeministrit (ZK). Strategjitë të cilave i ka kaluar afati i përcaktuar nuk janë më të vlefshme.

¹⁷ Office of the Prime Minister, "List of Valid Strategic Documents", url. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/List_of_valid_strategic_documents.pdf

¹⁸ Ministry of Culture, Youth and Sport, "Kosovo Strategy for Youth 2013–2017" linku. https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/KOSOVO_STRATEGY_FOR_YOUTH.pdf

¹⁹ Ministry of Education, Science & Technology, "Strategy for Health Promoting in Kosovo 2019–2018", linku. http://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/docs/strategy-for-hps_health_promoting_schools-in-kosovo_1.pdf

²⁰ Ministry of Education, Science & Technology, "Kosovo Education Strategy Plan 2017–2021, linku. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/KOSOVO_EDUCATION_STRATEGIC_PLAN.pdf

²¹ Ministry of Justice, "National Strategy of the Republic of Kosovo for Protection from Domestic Violence and Action Plan 2016–2020, linku: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/STRATEGJIA_KOMB%3%8BTARE_E_REPUBLIK%3%8BS_S%3%8B_KOSOV%3%8BS_P%3%8BR_MBROJTJE_NGA_DHUNA_N%3%8B_FAMILJE.pdf

²² Office of the Prime Minister, "Republic of Kosovo National Strategy Against Terrorism", linku. http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/REPUBLIC_OF_KOSOVO_NATIONAL_STRATEGY_AGAINST_TERRORISM.pdf

²³ Ministry of Internal Affairs, National Authority against Trafficking in Human Beings, "National Strategy Against Trafficking in Human Beings in Kosovo 2015–2019", linku. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/NATIONAL_STRATEGY_AGAINST_TRAFFICKING_IN_HUMAN_BEINGS_IN_KOSOVO.pdf

²⁴ Office of the Prime Minister, "Strategy on Prevention of Violent Extremism and Radicalisation Leading to Terrorism 2015–2020, linku. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGY_parandalim_-_ENG.pdf

Çfarë është duke munguar

Strategjia ekzistuese, edhe pse i përshijnë disa nga çështjet kyçe që kanë të bëjë në inkuadrimin e rinisë në jetën publike, qoftë në vendimmarrje apo nëpërmjet aktivizmit rinor në organizatat joqeveritare, ato nuk e mbulojnë në mënyrë specifike problemin e DHF dhe DHBGJ si çështje e të rinjve edhe pse në fakt janë një pengese e madhe për mirëqenien dhe sigurinë e tyre. Fjala dhunë nuk përmendet as tëvetmen herë në Strategjinë e Kosovës për Rininë 2013 – 2017. Strategjia e re për rininë 2019 – 2023 ka filluar sëzbatuari, mirëpo ne nuk e dimë nëse strategjia e re parasheh inkuadrimin e të rinjve në programe të parandalimit të dhunës apo nëse DHF dhe DHBGJ janë përmendur si një ndër problemet me të cilat ballafaqohen të rinjtë në Kosovë. Ne nuk kemi pasë qasje në strategjinë e re pasi sipas zyrtarëve të MKRS-së, ajo është ende duke u zhvilluar. Gjatë lansimit të strategjisë, Ministri Kujtim Gashi ka deklaruar se strategjia e re ka për qëllim të "parandaloj përhapjen e fenomeneve negative që ndikojnë në sigurinë dhe mirëqenien e rinisë"²⁵. Tri nga objektivat strategjike në strategjinë për rini 2013 -2017 janëpërqendruar në rolin e rinisë si shtysë të ndryshimit në fushën e arsimimit, shëndetësisë dhe sigurisë. Objektiva e arsimimit joformal përqendrohet që në Kosovë të ketë "tërijnë tëarsimuar dhe të gatshëm për tu ballafaquar me të gjitha sfidat e jetës, të jenë pjesëmarrës të vetëdijshëm të komunitetit lokal dhe Evropian". Objektiva e promovimit të shëndetit dhe edukimit ka të bëjë "(rini që) është e vetëdijshme për rëndësinë e mbrojtjes shëndetësore, për mirëqenien e sajë individuale dhe shoqërore, si dhe të kontribuon si qytetarë të arsyeshëm të shtetit", përderisa objektiva e sigurisë njerëzore ka për qëllim që ta ketë "rininë e përgatitur ta identifikojë, parandalojë dhe adresojë me kohë dhe efikasitet rreziqet të cilat e kërcënojnëatë."²⁶.

Përderisa të gjitha këto komponentë janë shumë të rëndësishme për krijim e hapësirësku palët e interesuara mund të zhvillojnë aktivitete të cilat fokusohen nëformat e ndryshme të parandalimit të dhunës, nëse vërtetëdëshirojmë të bëjmë ndryshim dhe të zhvillojmë politika të cilat janë relevante për kohën dhe vendin për të cilat ju dedikohen, është tejet e rëndësishme që të ekzistoj një komponentë specifike qëpërqendrohet në probleme specifike të DHF-së dhe DHBGJ-së . Ne mund të parandalojmë dhe zgjidhë probleme vetëm duke ju qasur atyre ashtu siç janë dhe duke qene eksplcicit për to. Për shembull, ekstremizmi i dhunshëm në Kosovë adresohet si një problem shumëspecifik me të cilin ballafaqohen njerëzit në Kosovë dhe e njëjta qasje do të duhej të përdoret në adresimin e DHF dhe DHBGJ, pos faktit qëduhet konsiderohen si një ndër kërcënimet më të mëdha për mirëqenien dhe sigurinë e shoqërisë tonë.

²⁵ KOHA Net, "Prezantohet strategjia e re nacionale për rini 2018-2022" (20 Shtator 2018), linku: <https://www.koha.net/arberi/118289/prezantohet-strategjia-e-re-nacionale-per-rini-2018-2022/>

²⁶ Ministry of Culture, Youth and Sport, "Kosovo Strategy for Youth 2013-2017" Linku. https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/KOSOVO_STRATEGY_FOR_YOUTH.pdf

Edhe pse disa nga objektivat të Strategjisë Kombëtare të Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 2016 – 2020 përqendrohen tek rritja e vetëdijes dhe parandalimit të dhunës, në këtë strategji të rinjtë nuk janë grup i synuar që mund të luaj një rol të madh në betejën kundër DHF nëpërmjet metodave të parandalimit primar. Mirëpo strategjia thekson rëndësinë e rritjes së vetëdijes në të gjithë shoqërinë rreth “mopranimit dhe mos-tolerimit të akterëve të dhunës në familje”.²⁷ Një ndër objektivat e kësaj strategjie është edhe rritja e përqindjes së njerëzve të vetëdijshëm për format e ndryshme të dhunës dhe rritjen e përqindjes të atyre që kundërshtojnë DHF, mirëpo nuk ka indikatorë të qartë se si këto synohen të arrihen.

Strategjia për Promovimin e Shëndetësisë nëpër Shkollë në Kosovë 2009 – 2018, edhe pse nuk është më vlefshme, vendos një themel të mirë të praksës së mirësi i përket inkuadrimit të rinisë nëpërmjet shkollave si dhe implementimit të programeve vetëdijuese mbi çështjet e shëndetit. I njëjti sistem do të mund të përdorej në programet e parandalimit të dhunës. Parandalimi primar ka të bëjë me rritje të vetëdijes, krijimit të hapësirave ku të rinjtë do të mund të bashkohen, kundërshtojnë normat e dëmshme që promovojnë dhunën, si dhe ku e marrin dijen e nevojshme për ta arritur këtë. Parandalimi primar do të ishte i suksesshëm kur do tëzbatohet nëpërmjet shkollave dhe institucioneve dhe organizatave, përderisa është thelbësore të krijohet qasje për ata që nuk e kanë atë.

Në përgjithësi, strategjitë ekzistuese nuk janë duke i shfrytëzuar rrugët e duhura për ti adresuar problemet e DHF dhe DHBGJ, nuk përqendrohen tek rinia si subjekte të ndryshimit si dhe nuk e fuqizojnë rolin e tyre në krijimin e një shoqërie më të mirë për të gjithë. Politikat kombëtare në këtë fushë do të duhej të plotësoheshin me politikat lokale të përshtatura për nevojat lokale. Nga diskutimet që kishim me të rinjtë e shtatë rajoneve të Kosovës, Gjakovë, Gjiçan, Ferizaj, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren, ne kemi vërejtur njëngjashmëri të sfidave në të gjitha rajonet. Disa nga këto sfida kishin të bënin me çështjet e DHF dhe DHBGJ si probleme të cilat të rinjtë nganjëherë nuk i identifikojnë lehtë, përkundër faktit që të dyja forma të dhunës kanë tendencë që të merren si normale në mjedisin e tyre, qoftë në shkollë, universitete apo në familje.

Rëndësia e inkuadrimit të të rinjve

Kosova duhet t’ju bashkëngjitet përpjekës globale për ta njohur rolin e rëndësishëm që të rinjtë luajnë në procesin e krijimit të shoqërisë dhe vendeve më të sigurta. Është shumë me rëndësi që të aplikohet qasja e Zhvillimit Pozitiv e Rinisë në raste qëllim është rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në parandalimin e dhunës, për faktin se kjo qasje “fokusetohet jo vetëm tek parandalimi i problemeve por bazohet

²⁷ Ministry of Justice, “National Strategy of the Republic of Kosovo for Protection from Domestic Violence and Action Plan 2016-2020, 27.

nëvetëfuqitë e të rinjve”.²⁸Në përpjekjen që të njihet botërisht që “të rinjtë luajnë rol pozitiv dhe të rëndësishëm nëmbarrëvajtjen dhe promovimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare”²⁹, Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara ka miratuar rezolutën mbi Rininë, Paqen dhe Sigurinë, dhe Kosova, edhe pse nuk është anëtarë e Kombeve të Bashkuara, do të duhej ta njoh këtë rezolutë si dokument të rëndësishëm qëka mundësi udhëheq punën tonë me të rinjtë e Kosovës, sidomos pasi që të rinjtë përbëjnë 53% të popullsisë në Kosovë.

Disa nga zyrtarët qeveritarë në Kosovë kanë theksuar rëndësinë e inkuadrimit të të rinjve në aktivitetet që kanë të bëjnë me parandalimin e dhunës. Për ditën ndërkombëtare të fëmijëve, me 1 Qershor 2018, zëvendës ministri i Ministrisë së Drejtësisë dhe njëkohësisht koordinator Kombëtar Kundër i Dhunës në Familje, ka deklaruar që është e domosdoshme të bëhet një punë adekuate dhe sistematike me gjeneratat e reja rreth parandalimit të dhunës.³⁰Po ashtu, Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Dhunës në Familje e cilëson dhunën në familje si një problem që duhet të adresohet në sistemin e arsimit. Kjo është një qasje e mirë duke e marrë parasysh që institucionet arsimore janë mënyra më e përshtatshme për ti inkuadruar të rinjtë në parandalimin e dhunës që nga mosha e hershme. Shtuar kësaj, në Mars të vitit 2018, Koordinator i Kombëtar ka kërkuar nga MASHT-i që të filloj me procesin e rekrutimit të psikologëve nëpër shkolla në mënyrë që të përmirësohen mënyrat e trajtimit të sjelljes së dhunshme të nxënësve si dhe çështjet e tjera të lidhura me shëndetësi dhe siguri

²⁸ Andrea Poet, Catherine R. Swiderski, and Maureen C. McHugh, *Developing teen Relationships: The role of Violence*, ed. Michele A. Paludi (Santa Barbara, CA: Praeger, 2011), 226.

²⁹ Youth4Peace, UNSCR 2250 Introduction, url: <https://www.youth4peace.info/UNSCR2250/Introduction>

³⁰ Ministry of Justice Kosovo, “Deputy Minister Qelaj congratulates all children on the occasion of June 1st, the International Day of Children” (1 June 2018), url: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15,1864>

Temat e përbashkëta të dala nga fokus grupet

Gjatë diskutimi me të rinjtë, ne kemi pasë për qëllim që ti zbulojmë besimet dhe qëndrimet e tyre ndaj cilësdo forme të dhunës, duke u përqendruar kështu në dhunën në familje dhe dhunën në baza gjinore, si dhe ti identifikojmë mundësitë më të mira për ti inkuadruar ata në programe tëparandalimit të dhunës. Gjatë këtyre diskutimeve ne kemi krijuar hapësira të sigurta për ta në mënyrë që ti kuptojmë mirëpërvojat e tyre tëpërbashkëta si dhe ti sfidojmë besimet e tyre. Disa nga temat kryesore që kanë dalë nga këto diskutime kërkojnë një vëmendje më të madhe mbi nivelin alarmant të dhunës në jetën e përditshme e tërinjve si dhe reflektim mbi hapave që do të duhej të merreshin që kjo të ndryshohet.

Për ti kuptuar më mirë trendët e dala nga këto diskutime, ne i paraqesim të dhënat në grumbulluara në pesë kategori:

- Dija: Si të rinjtë e definojnë dhunën? A dinëta dallojnë atë kur ajo ndodhë?
- Besimet: Cilat janë besimet e tyre rreth rroleve dhe normave tradicionale gjinore dhe a i arsyetojnë këto norma dhunën në familje dhe dhunën në baza gjinore?
- Informimi: Si dhe çfarë informacioni ju ofrohen të rinjve nga institucionet përgjegjëse, shkollat dhe familja rreth parandalimit të dhunës?
- Përvoja: Analizimi i përvojës e të rinjve me dhunën, si kanë ndikuar ato te ata, kur dhe si ka ndodhë ato?
- Nevojat: Këtu ne shqyrtojmë çfarë duhet të bëhet në mënyrë që ti pajisim të rinjtë me informacionin e nevojshëm që t'ju mundësohet të veprojnë si subjekt të ndryshimit dhe, më e rëndësishme, cilat janë nevojat e tërinjve?

Dija: Hapi i parë drejt parandalimit të dhunës është të definohet dhe të kuptohet kur ajo ndodh. Disa nga format e dhunës të cilat pjesëmarrësit i kanë përmendur më së shpeshti janë dhuna fizike, psikologjike dhe emocionale si dhe abuzimi verbal. Njëanën tjetër, kishte nga të tillë pjesëmarrës qëkishin më shumëproblem në identifikimin e formave të tjera të dhunës sikurse dhuna seksuale, ngacmimi seksual dhe abuzimi financiar. Sipas tyre, dhuna është detyrimi që i ushtrohet individit për ti detyruar tëveprojnë në mënyrë të cilën këta të fundit nuk ndihen rahat, trajtimi i pabarabartë i njerëzve që konsiderohen ndryshe në ndonjë aspekt, nganjëherë edhe komunikimin që mund të bëhet në mënyrë abuzive. Abuzimi verbal, sipas pjesëmarrësve është më se prezent në jetën e përditshme, përfshirë këtu bulizmin në shkolla. Shumica e pjesëmarrësve kanë deklaruar se dhuna emocionale dhe psikologjike kishte apo do të kishte ndikim më të thellë në jetën e tyre sesa dhuna fizike. Njëri nga pjesëmarrësit ka deklaruar qësecili në momente të caktuara do të ndihej që më mirë të qëlloheshin

fizikisht sesa të qortohen në mënyra tjera, sidomos nëse këta të fundit janë anëtar të familjes. Edhe pse abuzimi emocional është një pjesë e madhe e dhunës familjare, sipas tyre, është vështirë të raportohet pasi që nuk mënyrë që kjo të vërtetohet si dhe askush nuk do t'ju besonte. Mirëpo, raportimi i dhunës në familje, edhe në raste që kjo dhunë ishte dhunë fizike, përsëri kjo gjë do të konsiderohej tabu pasi që dhuna në familje ende konsiderohet si një çështje private. Vajzat, në krahasim me djemtë, më shumë e kanë përmendur vrasjen e grave në Kosovë dhe si ato janë ndikuar nga normat gjinore patriarkale. Në anën tjetër kishte edhe pjesëmarrës që konsideronin dhunën si zgjedhje për probleme të ndryshme, p[er]o ashtu edhe si dhe reagim logjik ndaj kërcënimit dhe situatave të padëshiruara.

Besimet: “Policia nuk duhet të përzihet në çështje familjare” ishte njëra përgjigje e dhënë ndaj pyetjes nëse do ta mendonin ta njoftojnë policinë në rast që do të ndodhte që këta të ishin dëshmitarë të dhunës qoftë në familje të tyre apo tek fqinjët e tyre. Edhe në raste kur të rinjtë e definonin dhunën në familje, ata kishin mëdyshje rreth raportimit të dhunës pasi që ata konsideronin se nuk është roli i tyre të përzihen në “çështje familjare” si dhe besonin se marrëdhënia e tyre me anëtarët e familjes do të rrezikohej në rast se do të thirrej policia apo do të raportohej ndokund. Sikurse vajzat, ashtu edhe djemtë kanë theksuar se normat gjinore tradicionale të dominimit të burrit ndaj gruas kontribuon në dhunë, mirëpo në anën tjetër, disa pjesëmarrës do ta arsyetonin dhunuesin pikërisht për shkak të atyre normave. Shumica e njerëzve që kryejnë akte të dhunës, sipas tyre, e bëjnë atë gjë pasi që ata vetë ishin viktimë të dhunës në familje apo shkollë. Në këtë kontekst, dhuna në shkollë reflekton besimin e të rinjve që dhuna ndikohen nga normat gjinore që normalizojnë dhunën në familje dhe ngado tjetër. Është shumë shqetësues fakti që dhuna ndërmjet nxënësve është e pranueshme dhe shkolla e normalizon këtë të fundit.

Informimi: Pospolicisë, pjesëmarrësit kishin vështirësi për të identifikuar institucionet tjera ku ata mund ta raportojnë dhunën. Po ashtu, nuk ka ndonjë informacion që ju ofrohet në shkollë rreth kësaj çështje. Informatat e këtij lloji i marrin më së shumti nga rrjete sociale dhe mediat tradicionale, ndërkohë që shumë pak është bërë nga vetë shkollat apo ndonjë organizatë tjetër në këtë drejtim. Vetëm disa pjesëmarrës kanë po huar që kanë marrë pjesë në aktivitete ku ata kanë folur rreth dhunës dhe janë informuar për mënyrat e raportimit të tyre.

Përvoja: Abuzimi verbal në shtëpi, ngacmimi seksual në shkollë, presioni nga shkollë dhe familja, komunikimi i ultë me anëtarët e familjes dhe njerëzit të afërt me ta, mosbesimi në autoritetet e shkollës, këto janë vetëm disa nga sfidat të cilat të rinjtë ballafaqohen në Kosovë dhe të cilat kanë tendence të ndikojnë në sjellje të dhunshme që marrin formën e DHF dhe DHBGJ. Familja shpesh është vend ku dhuna fillon dhe arsyetohet, ndërkohë që vetë shkollat në shumicën e rasteve përfaqësojnë institucion

ku dhuna, sidomos ngacmimi seksual nga ana e mësimeve, është gjë e pranueshme, ndodh fajësim i viktimës, dhuna ndërmjet djemve inkurajohet si dhe dhuna fizike dhe verbale e profesorëve pranohet. Pjesëmarrësit theksojnë se për ta është e pakuptim që ta raportojnë dhunën në shkollë, sidomos kur kjo dhunë bëhet nga ana e mësimeve apo stafi tjetër i shkollës. Së pari, nuk do të kishte reagim konkret nga ana e shkollës, asnjë masë nuk do të merrej dhe fjala e nxënësve nuk do merrej seriozisht apo nuk do t'ju besohej atyre në rast të raportimit. Të vetmit që do të ndëshkoheshin do të ishin vetë nxënësit. Ata do të fajësoheshin për dhunën si dhe mësimeve do t'ju hakmerreshin me nota të ulëta. Në anën tjetër, ata nuk u ndiheshin të sigurtë të flasin për këtë dhunë nëshpirtë e tyre. Ata do të hezitonin t'ju kallëzonin për dhunën anëtareve të familjes pasi që do të dëgjonin gjëra sikurse "patjetër që ti ke bërë ndonjë gjë për ta merituar atë", "ata janë profesorë dhe ata e dine çfarë janë duke bërë", apo "nuk ishte ashtu siç të duket".

Kur janë pyetur nëse do ti ndanin këto përvoja me psikologët në shkollë, shumica nga ata deklaruan se nuk ka psikologë në shkollat e tyre, ndërsa disa nga nxënësit nuk ishin të vetëdijshëm që mund të ketë psikologë nëpër shkollë. Mirëpo edhe po që se do të ekzistonte një psikolog/e në shkollë, ekziston një stigmë rreth punës së psikologëve dhe rrjedhimisht nxënësit hezitojnë të flasin me ta. Po ashtu, ka pasur raste kur psikologët do ti ndanin informacionet me të tjetër apo me anëtarët e familjes. Pra parimi i fshehtësisë nuk do të respektohej nga psikologët e përzgjedhur nga shkollë, gjë që e bënë më të vështirë që nxënësit të shprehën lirshëm apo të caktojnë ndonjë takim me ta.

Nevojat: Nxënësve ju nevojiten psikologë të kualifikuar dhe profesionistë në shkollë ku tani më janë të punësuar psikologët. Mirëpo, edhe pse do të duhej të ekzistonin psikolog në çdo shkollë, kjo gjë nuk është e vërtetë për të gjitha shkollat. Të rinjtë kanë theksuar se ende ekziston një stigmë rreth vizitës së psikologut/ës, prandaj një kampanjë vetëdijuese si dhe një program shkollor që prezanton punën e psikologëve është e nevojshme. Ata po ashtu kanë theksuar se kanë nevojë për më shumë programe ku ata mund të flasin lirshëm për problemet e dhunës, si ju ndikon ajo dhe çfarë mund të bëjnë ata që ta parandalojnë atë. Edukimi joformal duhet të krijoj mundësi që të rinjtë të flasin për dhunën seksuale dhe marrëdhënie intime të shëndetshme. Po ashtu ekziston nevoja për edukimin roline intervenimit si dëshmitar. Shkollat duket të koordinojnë programet e tyre me organizatat e tjera dhe të zhvillojnë programet e qëndrueshme për rininë në mënyrë që të marrin pjesë dhe të informohen rreth dhunës në përgjithësi dhe sidomos rreth mënyrës se si ata mund ta raportojnë dhe parandalojnë dhunën.

Rinia në Kosovë, edhe pse përbën një përqindje të madhe të popullatës dhe shihet si garantim për një të ardhme më të mirë për shtetin tonë, siç mund të shohim, ka tendencë të shihet nga qeveria si spektatorë kur ka të bëj me disa aspekte kryesore të zhvillimit dhe mirëqenies së shoqërisë tonë. Pa i marrë parasysh ligjet, strategjitë, institucionet qeveritare dhe mekanizmat e tjerë që punojnë për të ndaluar të gjitha format e dhunës në Kosovë, hulumtimet tregojnë se dhuna në baza gjinore dhe ajo në familje janë format më të shprehura në Kosovë dhe gratë dhe fëmijët vuajnë më së shumti si rezultat i kësaj dhune.

Nëse duhet të krijojmë një të ardhme më të mirë për të gjithë, nuk mund ta bëjmë duke i injoruar disa nga problemet më të mëdha që i hasim në të kohën e tashme. Duke i njohur këto probleme dhe se si ato ndikojnë në shoqërinë tonë, hapi i parë është për t'i ballafaquar, megjithatë, a është e mundur për ta bërë atë duke e përjashtuar një pjesë të madhe të shoqërisë, rininë? Dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore janë probleme në shoqërinë tonë që duhen të adresohet në nivele të ndryshme dhe duke e inkuadruar rininë për të ju dhënë fund këtyre problemeve duhet të bëhet në një spektër të gjerë. Duhet t'i qasemi rinisë si ndryshim-bërës aktiv nëse duam t'i japim fund disa prej kërcënimeve më të mëdha të ardhmes së tyre, dhunës në shtëpi të tyre, dhunës aty ku rriten dhe dhunës në mes nesh. Nuk duhet të ketë asnjë të ri që mund ta konsiderojë dhunën në familje si çështje private dhe nuk duhet të jetë asnjë i ri që mund të thotë "policia nuk duhet të përzihet në çështjet familjare". Nëse lejojmë të rinjtë të rriten të rriten me këto besime, jemi duke krijuar një të ardhme ku dhuna pranohet, dhe kështu do të ketë gra, burra dhe fëmijë të tjerë që do të vuajnë nga normat e dëmshme të cilat nuk i ndryshojmë sot.

Kosova si shtet me popullatë të re ku 53 përqind është nën moshën 25 vjeçare, duhet ti bashkëngjitet përpjekjeve globale për të përfshirë popullatën rinore në programe dhe të promovojë paqe të qëndrueshme dhe parandalim të dhunës. Nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme përderisa ka viktima potenciale të dhunës në familje dhe asaj gjinore në shkolla, universitete, shtëpia, ose kudo në shoqërinë tonë dhe përderisa të rinjtë rriten në ambiente ku dhuna pranohet dhe promovohet. Duke iu qasur të rinjve si agentë, do të krijonte mundësi për ta për të ushtruar të drejtat e tyre dhe për të arrirë potencialin e tyre të plotë në një shoqëri të lirë nga dhuna

REKOMANDIMET

Duke u bazuar në rezultatet e analizës së politikave të tanishme dhe procesit konsultues me palët e interesuara duke përfshirë rininë përgjatë Kosovës, ne i japim rekomandimet e mëposhtme për këto palë kyçe:

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

- Zhvillimi i një strategjie mbi rininë dhe parandalimin e dhunës. Kjo strategji duhet të fokusohet në krijimin e programeve primare parandaluese që kanë synojnë institucionet ku është më lehtë të arrihen më shumë të rinjtë, si shkollat. Programet duhet të fokusohen në krijimin e hapësirave për diskutim, sfidomi dhe ndryshim të normave gjinore dhe besimeve të cilat normalizojnë dhe promovojnë dhunën në çfarëdo forme sidomos në DHF dhe DHBGJ. Kjo strategji duhet të koordinojë punën e institucioneve ekzistuese si sektorët e rinisë në nivelet kombëtare dhe lokale dhe mekanizmave ekzistues përgjegjës për parandalimin e dhunës.
- Të përfshijë programe për parandalimin e dhunës si pjesë e një Strategjie të Kosovës për Rini 2019-2023.
- Kur zhvillohen strategjitë e reja; të shfrytëzojë mekanizmat ekzistues të konsultimeve si Këshillat Lokale të Veprimeve Rinore dhe Organizatave të Shoqërisë Civile të cilat punojnë me rininë.
- Shfrytëzimi i një qasjeje të orientuar kah problemi përkrah një qasjeje të orientuar nga burimi kur zhvillohet një strategji e re kombëtare për rininë. Duke identifikuar problemet me të cilat rinia ballafaqohet është hapi i parë drejt zhvillimit të strategjive efektive të orientuara nga burimi.
- Partneriteti me shkollat e mesme në Kosovë për të implementuar këtë strategji duke përfshirë ndryshimet në kurrikullat për të adresuar shkaqet rrënjësore të Dhunës në Familje dhe Dhunës në Baza-Gjinore në Kosovë, ashtu si ngacmimi, dhe diskriminimi në baza të tjera si etnia.
- Koordinimi i punës së OSHC me shkollat e mesme për të zhvilluar partneritet në mes të këtyre të dyjave dhe për të zbatuar aktivitete jashtë-mësimorë të cilat adresojnë problemin e dhunës.
- Rritja e mbështetjes politike, financiare, teknike dhe logjistike për sektorët e rinisë lokale për të zbatuar këtë strategji.

Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë:

- Zhvillimi i politikave që nxisin shkollat për të krijuar mundësi për rininë për të sfiduar rolet gjinore toksike. Kjo mund të përfshijë aktivitetet jashtë-mësimorë.
- Monitorimi i prezencës së psikologëve në shkolla në sistemin arsimor primar dhe sekondar dhe të implementojë plotësisht ligjin detyruar për psikologë në shkolla.

- Të iniciojë fushata për informimin publik për të diskredituar stigmat lidhur me këshillimin psikologjik.
- Të bashkëpunojë me shkollat e mesme për të krijuar një manual me informata për llojet e ndryshme të dhunës, shkaqet dhe se si mund të parandalohet e ku mund të raportohet.

Sektori i Rinisë përbrenda Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

- Të zhvillojë politika lokale rinore që korrespondojnë me kërkesat dhe nevojat lokale.
- Të zhvillojë dhe implementojë një strategji lokale për të ngritur vetëdijesimin mbi format e ndryshme të dhunës; të monitorojë dhe vlerësojë implementimin e kësaj strategjie.
- Të avokojë për programet që kanë për qëllim të ndryshojnë rolet gjinore shoqërore që e normalizojnë dhunën.
- Të kryejë një hulumtim në bashkëpunim me KVRL-të për të identifikuar nevojat lokale dhe mundësi për rininë duke u fokusuar në problemin e dhunës në mes rinisë dhe shkaqet e tij.
- Të bashkëpunojë me OSHC për të planifikuar dhe implementuar projekte të cilat e adresojnë problemin e dhunës.
- Bashkëpunimi me institucione të tjera si politika dhe gjyqet për të zhvilluar fushata për rritur vetëdijesimin mbi dhunën në familje dhe dhunën në baza gjinore.
- Të përmirësojë bashkëpunimin me OSHC-të lokale për të krijuar programe rinore të qëndrueshme.
- Të bashkëpunojë me shkollat për të aktivizuar këshillat e prindërve ku ato nuk janë aktive si dhe për të punuar afër me këto këshilla.

Agjencioni për Barazi Gjinore:

- Përfshirja e një segmenti që fokusohet në rolin e rinisë në programet për parandalimin e dhunës.

Organizatrat e Shoqërisë Civile të cilat punojnë me rininë:

- Bashkëpunimi me shkollat, me KVRL si dhe ministrinë e rinisë për të shtyrë përpara për ndryshime.

Organizatrat Ndërkombëtare në Kosovë:

- Të mbështesin zhvillimin e politikave për të rinjtë duke u fokusuar në rolin e rinisë në parandalimin e dhunës.
- Të sigurojë fonde drejt programeve që adresojnë forcat e të rinjve në luftën për të ndaluar dhunën në familje dhe në bazë gjinore.



European
Union
Kosovo